

VENDIM
Nr.48, datë 6.7.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “RUNNING ENERGY” PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE
PRODHUES (PARKU EOLIK MASKURI) SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, neni 8, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.7.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhuese (parku eolik Maskuri), si burime të rinovueshme energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “RUNNING ENERGY”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhuese (parku eolik Maskuri), si burime të rinovueshme energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta